

VENDIM
Nr.753, datë 8.9.2010

**PËR BASHKËPUNIMIN E INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS ME
INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRISË SË FINANCAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Inspektorati Shtetëror i Punës bashkëpunon me Ministrinë e Financave dhe institucionet në varësi të saj.

2. Inspektorati bashkëpunon me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, për shkëmbimin e informacionit për subjektet, pranë të cilave kanë ndodhur aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale.

3. Informacioni i dërguar nga Instituti i Sigurimeve përmban të dhënat, sipas formularit nr.1 dhe formularit nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Inspektorati Shtetëror i Punës bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për shkëmbimin e informacionit për subjektet e regjistruara pranë tyre.

5. Informacioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve duhet të përmbajë këto të dhëna:

a) emrin e subjektit;

b) prefekturën;

c) rrethin;

ç) NIPT-in;

d) llojin e veprimtarisë;

dh) adresën e qendrës ose filialit;

e) emrin e punëdhënësit;

ë) numrin e punëmarrësve;

f) numrin e punëmarrësve të deklaruar (të siguruar) në tatime, për çdo subjekt, rast pas rasti, për ndryshimin e numrit të punëmarrësve të deklaruar.

6. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQËRORE
AGJENCIA

FORMULARI Nr.1

EVIDENCË MBI AKSIDENTET NË PUNË DHE SËMUNDJET PROFESIONALE DHE DITËVE TË PAGUARA PËR TREMUJORIN__

NUMRI I IDENTITETIT	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	GJINIA	EMRI I SUBJEKTIT	NIPT	LLOJI I AKTIVITETIT	PREFEKTURA	RRETHI	DITË PAAFTËSIE	LLOJI I SËMUNDJES

Shënim. Kjo evidencë raportohet çdo tremujor nga DRSSH-të brenda datës 5 të muajit pasardhës të tremujorit.
Shënim. Për aksidentet në punë bashkëngjitet dhe fotokopje e procesverbalit të aksidentit.

K/DEGËS SË PËRFITIMEVE

K/DEGËS SË FINANCËS

DREJTORI
FORMULARI Nr.2

EVIDENCË MBI AKSIDENTET NË PUNË DHE SËMUNDJET PROFESIONALE DHE DITËVE TË PAGUARA PËR ---PROGRESIVE--

NUMRI I IDENTITETIT	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	GJINIA	EMRI I SUBJEKTIT	NIPT	LLOJI I AKTIVITETIT	PREFEKTURA	RRETHI	DITË PAAFTËSIE	LLOJI I SËMUNDJES

Shënim. Kjo evidencë raportohet progresive nga DRSSH-të brenda datës 5 të muajit pasardhës të tremujorit.

K/DEGËS SË PËRFITIMEVE

K/DEGËS SË FINANCËS

DREJTORI

